



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

| | |
|------------------|--|
| Datë : | 05.06.2017 |
| Referencë | 11-344/5 |
| Për : | Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti |
| Përmes : | Drejtpërsëdrejti |
| Nga : | Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - z. Imer Rrustemi |
| Lënda : | RAPORTI MUJOR-MAJ |

Pasqyra tabelare e punës për muajin –MAJ

| Inspektorët | Gjithsej | Inspektime me procesverbal | Pranime teknike | Fletëparaqitje për kundërvajtje | Inspektime për pirjen e duhanit | Vërejtje, njoftime | Mbyllje e përkohëshme | Lëndë e ekzekutuara gjyqësore | Inspektime të përbashkëta | Përqime sanitare | Vendosje e shiritav zyrtar | Inspektim i auto-taxi | Menaxhim i tregjeve | Aktvendime- ndalesa, urdhëresa | Kërkesa, pune me palë | Gjoha mandatore | Inspektim i kafshëve në thertore | Inspektime me polici | Inspektim i tokave bujqësore | Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike | Mallë me afat të skaduar |
|----------------------|-------------|----------------------------|-----------------|---------------------------------|---------------------------------|--------------------|-----------------------|-------------------------------|---------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------|---------------------|--------------------------------|-----------------------|-----------------|----------------------------------|----------------------|------------------------------|--|--------------------------|
| Biznesit | 591 | 46 | 26 | | | 75 | 19 | 1 | 99 | | | | 6 | 122 | 161 | | | | | 46 | 3186.30€ |
| Ambientit | 260 | 34 | | 1 | | 2 | | 2 | 112 | | | | | | 103 | 1 | 5 | | | | |
| Bujqësisë | 131 | 9 | | | | 32 | | | 22 | | | | | 2 | 50 | | | | 16 | | |
| Ndërtimtarisë | 54 | 21 | | 3 | | | | | 25 | | | | | 5 | | | | | | | |
| Trafikut | 478 | 41 | | 2 | | 112 | | | 53 | | | 121 | 10 | | 57 | | 82 | | | | |
| Sanitar | 226 | 22 | | 6 | 42 | 31 | | | 61 | 5 | | | | | 17 | | 42 | | | | 3186.30€ |
| Gjithsejtë | 1740 | | 26 | 12 | 42 | 2529 | 9 | 3 | 3725 | | | 121 | 16 | 129 | 388 | 1 | 42 | 87 | 16 | 46 | 3186.30€ |

Gjatë muajit Maj janë hasur në 25 biznese të pa regjistruara në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit, ku janë urdhëruar që të bëjnë regjistrimin e tyre pran ARBK-së, Lipjan, gjithashtu janë hasur 20 biznese pa pëlqim nga inspektorët e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor për plotësimin e kushteve tekniko higjienike, ku janë urdhëruar që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit për pranim teknik. Në bazë të kërkesës së një biznesit është asgjësuar mall i cili ka qen me afate të skaduar dhe mall i dëmtuar, vlera e së cilës ishte afërsisht 3186.30 €, dhe me peshë rreth 2017 kg

Është bërë inspektimi i subjekteve afariste të ndryshme ushqimore, e në veçanti inspektimi i gjellëtoreve si dhe disa restoranteve, ku të gjitha janë inspektuar në aspektin higjienik, kushtet e ruajtjes së mallit, afatshmëris etj. Po ashtu është bërë inspektimi i disa salloneve të ondulimit dhe zburimit, inspektimin e ëmbëltoreve si dhe depo që posedonte në shitje lëndë të parë për ëmbëlsira. Është dalë në vend ngjarje në f.sh Poturovc, dhe Sheshin Adem Jashari K. Lipjan, për shkak të dëmtimit të gypave të ujësjellësit gjatë punimeve të ndryshme, të cilët janë urdhëruar për sanimin e tyre, për çfarë urdhëresat janë respektuar.

Sa i përket hapësirave publike në qytet që bizneset i shfrytëzojnë përpara lokaleve, janë detyruar dhe janë pajisur të gjitha me pëlqim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike përveç 2 biznese ndaj të cilave është marrë masa ligjore ndaj tyre.

Në aspektin e ambientit sipas ankesave të qytetarëve është dalë në vendin e ngjarjes në disa fshatra si: Gracke, Bujari, Blinaje, Dobraje e Madhe etj. të cilat ankesa kishin të bëjnë me ujërat e zeza, mbeturinat, plehrat e kafshëve. Janë identifikuar të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave të cilat ekzistojnë, dhe ato të cilat janë pastruar muaj më parë nga K. Lipjanit. Ky inspektim është bërë në bazë të komisionit për Garën për Mjedis të Pastër të organizuar nga organizata GIZ.

Është punuar rreth shqyrtimit të disa lëndëve si pjesë e komisionit për Lejen Mjedisore Komunale, me ç ‘rast janë aprovuar 3 Leje Mjedisore Komunale.

Sa i përket ndërtimit në K. Lipjanit gjendja e është nënë kontrollin e vazhdueshëm, janë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi me leje nga K. Lipjanit. Objekte pa leje ndërtimi nuk ka pasur të identifikuar, përveç një mbindërtim të cilit u janë ndaluar punët dhe është rrethuar me shirita zyrtar.

Gjithashtu në muajin Maj është bërë inspektimi në Aeroportin Ndërkombëtar “ Adem Jashari “ në bashkëpunim me policin kufitare për auto-taksi të cilët tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve në relacione të ndryshme që operojnë në këtë rreth rreth të udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive e qytetit rreth licencave të ushtrimit të veprimtarisë.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar edhe objekte ndërtimore rreth ndërrim destinimit të Tokës Bujqësore, po ashtu është inspektuar vazhdimisht në teren në mbrojtjen e Tokave Bujqësore që po ju ndërrohet destinimit me mbushje dhe zhavorime nga kompanitë e ndryshme, ku është ndërprerë një punishte ku bëhej mbushja pasi që nuk posedonte ndërrim destinimin e tokës nga ajo Bujqësore në ndërtimore. Janë shqyrtuar ankesat lidhur me dëmtimin e të mbjellurave nga një strehimore e Qenve endacak. Janë inspektuar markete ushqimore për produkte ushqimore me prejardhje bimore.

Në tabelën më poshtë janë të dhënat numerike rreth punës së bërë nga Drejtorati i Inspektoratit

